

SHOQËRIA ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

NUOVA-AMAGLIO FUNGOROBICA

STATUTI

KAPITULLI I

EMRI, FORMA, SELIA DHE KOHËZGJATJA

1. EMRI I SHOQËRISË

- 1.1.** Emri i Shoqërise është “NUOVA-AMAGLIO FUNGOROBICA” (“Shoqëria”), e ndjekur në mënyrë të pandashme nga shkurtimi “shpk”, cili përfaqëson formën ligjore të saj.
- 1.2.** Ortakët e Shoqërise (“Ortakët ose Ortaku i vetëm”) gëzojnë përgjegjësi të kufizuar deri në limitin e kontributit përkates në kapitalin e shoqërës së përfaqësuar në kuota (“Kuota”).
- 1.3.** Në të gjitha dokumentat, faturat, reklamimet dhe botimet të lëshuara nga Shoqëria, pavarësisht nga mënyra e dërgimit, emri i saj do të ndiqet ose do te shoqérohet nga:
- 1.3.1.** fjalët "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar" ose "shpk".
 - 1.3.2.** numri i unik i identifikimit të subjektit (NUIS) i saj.
 - 1.3.3.** adresa e regjistruar, dhe
 - 1.3.4.** pasqyrimin e faktit që shoqëria është në procedura likuidimi, në qoftë se ky rast paraqitet.

2. FORMA LIGJORE

- 2.1.** Shoqëria është një subjekt i së drejtës shqiptare dhe ka formën ligjore të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuár (“sh.p.k”), në përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) (“Ligji i shoqërive”).

3. SELIA

- 3.1.** Selia e shoqerisë është në adresën: Rruga e Kosovarëve, Pallati Merlrose 2, Njësia Bashkiake 5, Tiranë, Shqipëri.
- 3.2.** Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë selinë e saj në një adresë dhe/ose në një qytet tjetër të Shqipërisë.

- 3.3.** Shoqëria mund të hapë degë të saj ose zyra përfaqësimi kudo brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

4. KOHËZGJATJA

- 4.1.** Shoqëria ushtron veprimitari tregtare për një kohëzgjatje të pacaktuar.

KAPITULLI II

OBJEKTI

5. OBJEKTI I SHOQËRISË

- 5.1.** Mbjelljen, kultivimin, mbledhjen, shpërndarjen, perpunimin, abmallazhimin, magazinimin, tregtimin me pakice dhe shumice, importin dhe eksportin e produkteve agrare dhe bimeve medicinale.

Prodhimin, magazinimin, tregtimin, importin dhe eksportin e produkteve ushqimore dhe cdo produkti tjeter.

- 5.2.** Kryerjen e sondazheve, studimeve të tregut dhe monitorimin e medias audio-vizive, të shkruara apo elektronike si dhe përpilimin e strategjive të shitjes dhe marketingut.

- 5.3.** Kryerja e çdo lloj aktiviteti që lidhet me veprimtarinë e agjentit, brokerit, komisionerit, ndërmjetësit pa u kufizuar nga veprimtaria që kryhet nga porositësi apo çdo palë tjeter e tretë.

- 5.4.** Shfrytëzimin ekonomik në çdo lloj forme të teknologjive, disenjove, markave, licencave, produkteve, pamjeve grafike si dhe çdo produkti tjeter.

- 5.5.** Kryerjen e veprimtarive të kërkimit dhe zhvillimit si pjesë e projekteve që sjellin risi ligjore, ekonomike, financiare apo teknologjike, të kryera me qëllim përfitimin e financimeve apo komisioneve nga palët e treta.

- 5.6.** Në përputhje me legjislacionin shqiptar, në mënyrë që të arrihet qëllimi i sipërpërmendur, Shoqëria ka të drejtë:

- 5.6.1.** të mundësojë trajnime profesionale për punëmarrësit e saj apo palë të treta;

- 5.6.2. të kryejë çdo transaksion në lidhje me pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe çdo aktivitet tregtar, financiar dhe industrial, dhënie-marrje me qira, të vendosë pengje dhe barrë hipotekore që mund të konsiderohen si të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e Shoqërisë;
- 5.6.3. të kryejë çdo aktivitet në lidhje me publikimin, marketingun apo reklamimin;
- 5.6.4. të zotërojë kuota/aksiione apo çdo lloj interesit tjetër në shoqëri të tjera, pavarësisht fushës në të cilën kryejnë veprimtari këto shoqëri.
- 5.7. Shoqëria kryen çdo lloj aktiviteti që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e favorizon atë.

Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore përkatëse. Ajo zbaton standartet më të larta të etikës.

6. NDRYSHIME

- 6.1. Shoqëria ka të drejtë të ndryshojë objektin e veprimitarisë së saj në çdo kohë në përputhje me parashikimet e këtij Statuti.

KAPITULLI III

KAPITALI I REGJISTRUAR, KUOTAT DHE ORTAKËT

7. KAPITALI I REGJISTRUAR

- 7.1. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është në total 100.000 (njëqind mijë) Lek, e ndarë në 1 (një) kuota, plotësisht të nënshkruar dhe të shlyer.
- 7.2. Kapitali i regjistruar i shoqërisë zotërohet nga Ortakët e Shoqërisë si më poshtë:

Eleonora Nelda Ali' - lindur me 16.10.1997, në Milano, Itali, banues në Busto Arsizio, Itali, Shtetase Italiane, me numër personal LAILRN97R56F205E, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar zotëruesh i 1 Kuote, me vlerë nominale 100 (njëqind) lek, e cila përfaqëson 100% të kapitalit të regjistruar

8. ANULIMI I KUOTAVE

- 8.1. Bazuar në nenin 80 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, Shoqëria ka të drejtë të anulojë kuotat e kapitalit të saj dhe t'i likuidojë ato sipas vlerës së tyre kontabël.
- 8.2. Shoqëria mund t'i anulojë kuotat e saj për shkak të:
- 8.2.1. Detyrimeve të Ortakëve ndaj palëve të treta;
 - 8.2.2. Shkrirjen, likuidimin dhe/ose falimentimin e Ortakut;
 - 8.2.3. Vdekjen e Ortakut dhe problemeve me trashëgiminë;
 - 8.2.4. Dëshirën e Ortakut për t'u larguar nga Shoqëria, tërheqjen e tij, në përputhje me nenin 101 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare;
 - 8.2.5. Përjashtimin e Ortakut në përputhje me Nenin 12 të këtij Statuti;
 - 8.2.6. Zvogëlimin e Kapitalit;
 - 8.2.7. Transferimin e Kuotave të parashikuar në Nenin 13 të këtij Statuti.

9. ZVOGËLIMI OSE ZMADHIMI I KAPITALIT TË REGJISTRUAR

- 9.1. Kapitali mund të zmadhohet ose të zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë, në përputhje me Kapitullin IV të këtij Statuti, dhe kërkesave të detyrueshme të Ligjit të Shoqërite.
- 9.2. Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para, me anë të kontributeve në natyrë ose me përfshirjen e rezervave dhe fitimit.
- 9.3. Zmadhimi i kapitalit kryhet nëpërmjet emëtit të kuotave të reja, apo nëpërmjet rritjes së vlerës së tyre. Kuotat do të jenë të nënshkruara dhe vlera e tyre do të jetë e shlyer plotësisht.
- 9.4. Shoqëria nuk mund të blejë asnjë kuotë të saj. Megjithatë me qëllim zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë, nëpërmjet vendimit për zvogëlimin e kapitalit, Ortakët mund të autorizojnë Administratorin të blejnë kuotat përkatëse dhe t'i anulojnë ato.

10. TË DREJTAT DHE DETYRIMET E ORTAKËVE

- 10.1.** Ortakë janë vetëm ata të cilët zoterojnë kuotat e Shoqërisë.
- 10.2.** Çdo kuotë i jep të drejtën e një vote çdo Ortaku në Asamblenë e Përgjithshme të Shoqërisë (Asambleja e Përgjithshme), të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në organet drejtuese, të drejtën për të marrë pjesë në shpërndarjen e fitimeve të Shoqërisë, sikundër të drejtat e parashikuara nga ky Statut dhe dispozitat ligjore të Ligjit të Shoqërive.
- 10.3.** Ortakëve do t'u jepen me kërkësë me shkrim, informacione dhe të dhëna në lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, duke përfshirë të drejtën që të kontrollojnë dokumentat dhe raportet e Shoqërisë.
- 10.4.** Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave transferohen tek çdo zotëruesh i ri i këtyre Kuotave.
- 10.5.** Detyrimet e Shoqërisë janë të garantuara nga kapitali i saj, dhe Ortakët mundet vetëm të mbajnë përgjegjësi brenda limitit të vlerës së kuotave që ata zoterojnë ose nuk kanë paguar ende; Ortakët nuk mbajnë përgjegjësi që tejkalojnë investimin e tyre përkatesisht në kapitalin e Shoqërisë (përveç garancive dhe huave që ata realizojnë).
- 10.6.** Shoqëria nuk mban përgjegjësi për borxhe ose detyrime të tjera të Ortakëve të saj.

PËRJASHTIMI NGA E DREJTA E VOTËS

- 11.1.** Në rast se kuotat e shoqërisë zoterohen nga më shumë se një ortak, një ortak përjashtohet nga e drejta e votës në rastin kur Asambleja e Përgjithshme është duke vendosur mbi:
- 11.1.1.** Vlerësimin e veprimtarisë së këtij Ortaku.
- 11.1.2.** Shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij.
- 11.1.3.** Ngritjen e një padie kundër tij, nga Shoqëria.
- 11.1.4.** Dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12. PËRJASHTIMI I NJË ORTAKU

- 12.1.** Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë me shumicë të thjeshtë një kërkesë drejtuar gjykatës për përjashtimin e një Ortaku, nëse ekzistojnë shkaqe të arsyeshme për këtë përjashtim. Konsiderohen shkaqe të arsyeshme:
- 12.1.1.** Ortaku me dashje ose nga pakujdesia i shkakton dëme Shoqërisë ose Ortakëve të saj;
- 12.1.2.** Ortaku me dashje ose nga pakujdesia shkel dispozitat e Statutit, të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, apo çdo ligj tjetër dhe/ose marrëveshjen ndërmjet Ortakëve.
- 12.1.3.** Ortaku është në një situatë që e bën të pamundur vazhdimin e operacioneve tregtare midis Ortakut dhe Shoqërisë.
- 12.1.4.** Ortaku, me veprimet dhe/ose mosveprimet e tij, e bën të pamundur ose pengon interesat e Shoqërisë, emrin e mirë dhe aktivitetin e saj.
- 12.1.5.** Abuzimi i Ortakut me të drejtën e votës mund të shkaktojë dëme të mundshme Shoqërisë siç mund të vlerësohet nga Asambleja e Përgjithshme rast pas rasti.
- 12.1.6.** Veprime të ndërmarra në kundërshtim me dispozitat e parashikuara në marrëveshjen e Ortakëve.
- 12.1.7.** Asambleja e Përgjithshme ka të drejtë të përcaktojë si shkaqe të arsyeshme çdo veprim apo mosveprim, si dhe çdo gjëndje të Ortakut, sipas rastit, me qëllim mbrojtjen e interesave të shoqërisë.
- 12.1.8.** Shoqëria ka të drejtë të kërkojë kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga Ortaku i përjashtuar.

13. TRANSFERIMI I PJESËVE TË KAPITALIT

- 13.1.** Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo të transferohen lirisht ndërmjet ortakëve si dhe çdo pale të tretë, pa asnjë kufizim, nëpërmjet:
- 13.1.1.** kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- 13.1.2.** shitblerjes;

- 13.1.3.** trashëgimisë;
 - 13.1.4.** dhurimit;
 - 13.1.5.** në çdo mënyrë tjeter të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- 13.2.** Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

KAPITULLI IV

ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

14. KOMPETENCAT

- 14.1.** Asambleja e Përgjithshme është organi drejtues i Shoqërisë e cili merr vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.
- 14.2.** Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
 - 14.2.1.** Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - 14.2.2.** Ndryshimet e statutit;
 - 14.2.3.** Emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve;
 - 14.2.4.** Emërimi dhe shkarkimi i ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuiduesve;
 - 14.2.5.** Përcaktimi i shpërblimit të Administratorëve, Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Likuiduesve;
 - 14.2.6.** Mbikqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të politikave tregtare nga Administratorët e Shoqërisë, përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - 14.2.7.** Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë;
 - 14.2.8.** Shpërndarjen e fitimit vjetor;

- 14.2.9.** Rritjen dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;
- 14.2.10.** Ndarjen dhe anullimin e Kuotave;
- 14.2.11.** Përfaqësimin në gjykatë të Shoqërisë dhe në procedura të tjera kundër Administratorëve;
- 14.2.12.** Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- 14.2.13.** Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të Asamblesë së Përgjithshme;
- 14.2.14.** Çështje të tjera që parashikohen nga Ligji ose Statuti.
- 14.3.** Në përputhje me nenin 81(3) të ligjit të shoqërive, gjatë kohës që kuotat e shoqërisë zotërohen nga Ortaku i Vetëm, të drejtat dhe detyrimet e Asamblesë së Përgjithshme, të përcaktuar në ligjin e shoqërive tregtare, në këtë statut apo në çdo ligj tjetër, ushtrohen nga Ortaku i Vetëm. Rrjedhimisht, në çdo rast që në këtë statut përcaktohet ushtrimi i një të drejta apo përm bushja e një detyrimi nga Asambleja e Përgjithshme, kjo e drejtë ushtrohet apo ky detyrim përm bushet nga Ortaku i Vetëm.
- 14.4.** Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme do të registrohen dhe depozitoohen në Regjistrin e Vendimeve (“Regjistri”). Mënyra e mbajtjes së regjistrat përcaktohet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Të dhënët e Regjistrat nuk mund të ndryshohen ose fshihen.
- 14.5.** Administratori është i detyruar të registrojë në Regjistër veçanërisht vendimet e mëposhtme:
- 14.5.1.** miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- 14.5.2.** shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- 14.5.3.** investime;
- 14.5.4.** vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 14.6.** Vendimet e paregjistruara në Regjistër janë absolutisht të pavlefshme.

15. MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

- 15.1.** Asambleja e Përgjithshme duhet të mblidhet në rastet e parashikuara nga Ligji për Shoqëritet, ligje të tjera ose nga Statuti dhe sa herë që është e nevojshme për mbrojtjen e interesave të Shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e Asamblesë së Përgjithshme do të zhvillohet të paktën një herë në vit.
- 15.2.** Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori; në rast se caktohet më shumë se një, nga secili prej tyre, ose nga çdonjëri prej Ortakëve që përfaqëson të paktën 5% të numrit total të votave në Asamblenë e Përgjithshme të shoqërisë.
- 15.3.** Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezulton ose ekziston rreziku që aktivitetet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- 15.4.** Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në çdo mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e të gjitha aseteve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 15.5.** Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5% e aseteve të Shoqërise, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 15.6.** Në rastet e parashikuara në nenet 15.3 dhe 15.5, Asamblesë së Përgjithshme i paraqitet një raport nga një ekspert kontabel i autorizuar, i pavarur.
- 15.7.** Gjithashtu, në rastet e parashikuara në nenet 15.3 dhe 15.5 Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

16. MËNYRAT E THIRRJES

- 16.1.** Asambleja e Përgjithshme do të mblidhet të paktën një herë në vit.
- 16.2.** Asambleja e Përgjithshme thirret të vendosë për çështjet e përcaktuara nga Ligji për Shoqëritet, Statuti si dhe për çdo çështje e cilat nuk i është deleguar Administratorëve.
- 16.3.** Asambleja e Përgjithshme mblidhet në selinë e Shoqërisë, në selinë e një dege të shoqërisë në Tiranë, Shqipëri apo në çdo qytet apo provincë të botës siç bihet dakord midis Ortakëve.

- 16.4.** Ortakët njoftohen me shkrim ku përcaktohet: Vendi i zgjedhur, data dhe ora e mbledhjes si dhe rendi i ditës. Lajmërimi me shkrim u njoftohet Ortakëve me postë të regjistruar ose elektronike jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Prova për njoftimin e rregullt do t'i bashkangjiten si Aneks procesverbalit të Mbledhjes.
- 16.5.** Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me kërkesat e nenit 16.4, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët bien dakort për vazhdimin e mbledhjes dhe heqjen dorë nga pretendimet mbi mënyrën e thirrjes. Vendimet e marra nga Ortakët duhet të jenë me shkrim dhe duhet të firmosen nga të gjithë Ortakët. Këto vendime mund të firmosen edhe nga perfaqësuesit e Ortakeve. Dispozitat e pikës 16.4 nuk zbatohen kur Ortakët mund të shfaqin nevojën për të marrë një vendim jashtë Mbledhjes së Zakonshme të Asamblesë së Përgjithshme me anë të e-mail-it, fax-it apo çdo mjeti tjeter korespondence. Përsa i përket vendimeve që merren jashtë Republikës së Shqipërisë, Administratorëve u vihet në dispozicion një kopje e shkruar e këtyre vendimeve të cilën Administratori(ët) e ruajnë në Registrin e Vendimeve të Ortakëve të Shoqërisë, që mbahet në selinë e Shoqërisë, nën kujdesin e Administratorëve. Në rast se Asambleja e Përgjithshme nuk është thirrur në përputhje me kërkesat e këtij paragrafi, kjo e fundit mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se të gjithë ortakët bien dakort.
- 16.6.** Secili prej Ortakëve gjëzon të drejtën të përfaqësohet nga një person tjeter në përputhje me nenin 85 të Ligjit të Shoqërisë.
- 16.7.** Ortakët pranojnë dhe bien dakord me të drejtën për të marrë vendime në lidhje me Shoqërinë në formë të shkruar. Rezoluta e propozuar së bashku me dokumentacionin mbështetës do t'u dërgohet Ortakëve me postë, korrier, telecopy ose mënyra të tjera elektronike të sigurta. Ortaku(ët) do të marrin vendim për rezolutën përkatëse brenda një periudhe prej 30 ditësh nga dita që iu është dorëzuar rezoluta. Ortaku(ët) miratojnë rezolutën duke i kthyer Administratorit(ëve) të Shoqërisë një kopje të firmosur të rezolutës me shkrim. Ortakët te cilët nuk janë dakord me rezolutën shprehin me shkrim kundërshtitë e tyre në lidhje me rezolutën dhe i'a kthejnë atë Administratorit(ëve) të Shoqërisë. Rezoluta me shkrim konsiderohet e miratuar nëse aprovohet nga shumica e kërkuar në përputhje me nenin 17.
- 16.8.** Secili prej Ortakëve ka të drejtën e 1 vote për çdo kuotë.

- 16.9.** Vendimet e Ortakëve të marra në përputhje me këtë statut si dhe me Ligjin për Shoqëritë do të jenë të detyrueshme për Shoqerinë. Në rast se këto rezoluta miratohen jashtë Republikës së Shqipërisë, evidenca me shkrim e këtij vendimi do t'i dorëzohet Administratorit(ëve), i cili e regjistron në Regjistrin e Vendimeve të Ortakëve të Shoqërisë.
- 16.10.** Në rast se ligji e kërkon, rezolutat e Ortakëve duhet të noterizohen nga një noter publik Shqiptar. Në rast se këto rezoluta miratohen jashtë Republikës së Shqipërisë, ato duhet t'i nënshtrohen kërkesave të ligjit Shqiptar për njohjen e dokumenteve të huaja në Republikën e Shqipërisë (pra duhet t'i nënshtrohen procedurës së superlegalizimit ose apostillimit, në varësi të vendit ku lëshohen).
- 16.11.** Administratorët duhet të mbajnë procesverbalet e çdo mbledhjeje të Asamblesë së Pergjithshme, në përputhje me kërkesat e nenit 90 të Ligjit të Shoqërise.

17. KUORUMI DHE MARRJA E VENDIMEVE


- 17.1.** Shoqëria respekton dispozitat e Nenin 86 "Kuorumi" të Ligjit për Shoqëritë Tregtare.
- 17.2.** Në përputhje me nenin 86 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, vendimet e mëposhtme miratohen me shumicë të cilësuar: ndryshimi i statutit, zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit të regjistruar, shpërmdarja e fitimeve, zgjedhja e administratorit, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.
- 17.3.** Sipas nenit 86 të Ligjit për Shoqëritë Tregtare, në të gjitha çështjet që miratohen me Shumicë të Thjeshtë, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime që konsiderohen të vlefshme nëse në të marrin pjesë Ortakë që përfaqësojnë më shumë se 30% të numrit total të votave.

KREU V

ADMINISTRATORI

18. ADMINISTRATORI

- 18.1. Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator, të Drejtat dhe Detyrimet e të cilit janë të parashikuara në Ligjin për Shoqërîtë Tregtare, në Statutin e Shoqërisë si dhe në Aktin e Emerimit të tij.
- 18.2. Administratori i një shoqërie mëmë nuk mund të zgjidhet administrator i Shoqërisë së kontrolluar, dhe anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- 18.3. Administrator i parë i Shoqërisë është:

Të dhënat e identifikimit	Specimeni i nënshkrimit
Eleonora Nelda Ali' - lindur me 16.10.1997, në Milano, Itali, banues në Busto Arsizio, Itali, Shtetase Italiane, me numër personal LAILRN97R56F205E, madhore dhe me zotësi të plotë për të vepruar	

- 18.3.1. Kohëzgjatja e funksionit të Administratorit është për një periudhë prej 5 vjetësh, duke filluar që nga momenti kur kjo detyrë merr fuqi ligjore, me të drejtë rizgjedhjeje.
- 18.3.2. Administratori zgjidhet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë të cilësuar.
- 18.3.3. Administratori mund të shkarkohet në çdo kohë me shumicë të zakonshme nga Asambleja e Përgjithshme.
- 18.4. Administratori vepron individualisht dhe si firmëtar i vetëm në lidhje me çdo çështje të Shoqërisë e cila i është caktuar shprehimisht ose në rast se nuk i është përcaktuar shprehimisht, çdo çështje që përfshihet në administrimin e zakonshëm të shoqërisë.

19. TË DREJTAT DHE DETYRIMET

- 19.1. Të gjitha vendimet e marra nga administratori do të quhen të vlefshme kur: janë firmosura nga ai dhe janë në përputhje me legjisacionin shqiptar.
- 19.2. Kompetencat e Administratorit përfshijnë:

- 19.2.1.** Thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, në rastet e përcaktuara nga ky statut apo nga legjislacioni në fuqi.
- 19.2.2.** Menaxhimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë nëpërmjet implementimit të politikave dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme.
- 19.2.3.** Përfaqësimin e Shoqërisë.
- 19.2.4.** Kujdesin për mbajtjen në mënyrë të përshtatshme të dokumentave dhe librave kontabël të Shoqërisë.
- 19.2.5.** Përgatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve që i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme.
- 19.2.6.** Krijimin e një sistemi paralajmerimi për rr Ethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë.
- 19.2.7.** Kryejnë regjistrimet dhe dërgimin e të dhënave të Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, kur eshte e nevojshme.
- 19.2.8.** Raportimin përpara Asamblese së Përgjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë.
- 19.2.9.** Kryerjen e detyrave të tjera të caktuara në ligj, nga Asambleja e Përgjithshme si dhe nga Akti i Emëritit të tij.
- 19.3.** Administratori mbikqyr dhe siguron që zyrtarët, agentët, të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë.

20. DETYRIMI I BESNIKËRISË DHE PËRGJEGJËSIA

- 20.1.** Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikerisë, sipas neneve 14, 15, 17 dhe 18 të Ligjit të Shoqërive, administratori detyrohet:
- 20.1.1.** të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj, në këtë Statut ose në Aktin e Emëritit të tyre në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmëndje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjesid;

- 20.1.2.** të ushtrojnë kompetencat, që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- 20.1.3.** të vlerësojë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;
- 20.1.4.** të parandalojë dhe menjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ato të Shoqërisë;
- 20.1.5.** të garantojë miratimin e marrëveshjeve sipas dispozitave të pikes 3 të nenit 13 të Ligjit të shoqërive;
- 20.1.6.** të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.

KREU VI

ADMINISTRIMI FINANCIAR I SHOQËRISË

21. EKSPERTI KONTABËL

- 21.1.** Asambleja e Përgjithshme duhet të caktojë ekspertin kontabël të autorizuar në numrin dhe kohëzgjatjen e përcaktuar nga legjislacioni shqiptar.
- 21.2.** Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.

KREU VII

AKTIVITETI I SHOQËRISË

22. VITI FINANCIAR

- 22.1.** Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit.

DAA

23. MBAJTJA E LLOGARIVE

- 23.1.** Shoqëria do të mbajë llogaritë në lek dhe në monedhë të huaj.

24. LLOGARITJA DHE SHPËRNDARJA E FITIMIT

- 24.1.** Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit të aprovuar nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me Statutin, dhe me ligjet e zbatueshme.
- 24.2.** Nga fitimet vjetore, do të caktohet një fond rezervë në përputhje me kushtet e legjislacionit shqiptar për fondin rezervë të detyrueshëm.
- 24.3.** Në bazë të Ligjit për Shoqëritë, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortakët vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:
- 24.3.1.** asetet e Shoqërisë mbulojne teresisht detyrimet e saj;
 - 24.3.2.** Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve në vazhdim.

KREU VIII

NDRYSHIMI I FORMËS LIGJORE DHE PRISHJA E SHOQËRISË

25. NRYSHIMI I FORMËS LIGJORE

- 25.1.** Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 14 të këtij Statuti dhe në përputhje me dispozitat përkatëse të Legjislacionin Shqiptar.
- 25.2.** Shoqëria e re do të përbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.

26. PRISHJA E SHOQËRISË

- 26.1.** Shoqëria mund të prishet në rr Ethanat e mëposhtme:
- 26.1.1.** si pasojë e perfundimit të kohëzgjatjes për të cilën ishte themeluar;
 - 26.1.2.** me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
 - 26.1.3.** hapje e një procedure falimentimi;
 - 26.1.4.** nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për 2 vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të Ligjit nr.9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
 - 26.1.5.** me vendim gjykate;
 - 26.1.6.** për arsyen e tjera të parashikuara nga Asambleja e Përgjithshme në çdo kohë.
- 26.2.** Administratori regjistron prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit nr. 9723, datë 3.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ia njofton vendimin kësaj të fundit për regjistrim.

KREU IX

TË NDRYSHME

27. TË TJERA

- 27.1.** Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat përkatëse të Ligjit për Shoqëritë.
- 27.2.** Firmosur sot më 25.03.2018 në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

Eleonora Nelda Ali'